

AKT THEMELIMI
PER KRIJIMIN SI PERSON JURIDIK TE SHOQËRISË TREGTARE
I&M-1998 shpk

Sot më datë 30.04.2024:

Unë e nënshkuara Melita Murati, e datëlindjes 20 Prill 1974, lindur në Fushë-Lurë Dibër dhe banuese në Tiranë me adresë Çollak; Nd. 216; Farkë; Farkë e Vogël; 1045, gjendja civile “e martuar”, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. 035139770 dhe numër personal H45420070V:

Si ortak i vetem themeloj shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar I&M-1998 shpk, me përcaktimet si më poshtë vijon:

Neni 1

Shoqëria e themeluar nga nënshkruesi i këtij akti do të ketë formën e kërkuar nga *Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”* si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Shpk).

Neni 2

Shoqëria themelohet me emrin I&M-1998 shpk, emër i cili do të pasqyrohet edhe në vulën zyrtare të shoqërisë. Shoqëria I&M-1998 shpk mund të përdorë emrin I&M-1998 shpk ose emrin I&M-1998.

Neni 3

Shoqëria do të ketë selinë qendore në adresën Rruga “Mine Peza”, Pallati 220, Shkalla 4, Kati 1, Ap. 25/1, Tiranë.

Me vendim të ortakut të vetëm të shoqërisë mund të hapen filiale të tjera brenda ose jashtë vendit.

Neni 3

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, në përputhje me objektin e saj për një periudhë kohe të pakufizuar, e cila fillon që nga momenti i regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Ortaku i vetëm i shoqërisë mund të vendosë kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e saj, një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

Shoqëria mund të ndryshojë emrin, selinë, objektin e veprimtarisë së saj me vendim të veçantë, dhe të pasqyrojë këto ndryshime në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 4

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, në përputhje me objektin e përcaktuar në këtë Akt Themelimi, bazuar në legjislacionin shqiptar si dhe në Statutin bashkëlidhur këtij Akt Themelimi.

Neni 5

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- a) Këmbim Valutor,
- b) Transferim i parave në emër dhe për llogari të institucionit financiar jo Bankë,
- c) Ushtrimi i veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime si agjent,
- d) Ushtrim i ndërmjetësimit të pagesave utilitare,
- e) Shoqëria ka të drejtë të kryejë shërbimet e transfertave të parave, shërbimin e pagesave, komisionerit dhe shkëmbimit të vlerave monetare (exchange) për llogari të saj apo të çdo subjekti financiar jobankë.

Për të realizuar objektivat e saj, shoqëria mund të ndërmarrë e të zhvillojë edhe çdo lloj aktiviteti tjetër të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që siguron të ardhura dhe fitime të ligjshme.

Objekti i shoqërisë nuk është i kufizuar nga pikat "a" deri në "d" të këtij neni.

Ortaku i vetëm gezon te drejten te beje ndryshime ne objektin e veprimtarise se shoqërisë që mund të zgjerohet ose zvogëlohet në varësi të interesave të shoqërisë.

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare I&M-1998 shpk është 2.500.000 Lekë (dy milion e pesëqind mijë lekë).

Kapitali themeltar është i ndarë në 1 kuotë dhe vlera nominale e një kuote është 2.500.000 lekë (dy milion e pesëqind mijë lekë), pra zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 2.500.000 lekë.

Ortaku i vetëm është zotërues i të gjitha kuotave të shoqërisë, në vlerën 100% të tyre.

Kuotat janë nominative dhe nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë.

Çdo kuotë përfaqëson të drejtën e një vote.

Neni 7

Shoqëria do të ketë organet e saj drejtuese që do të jenë:

- 1) Asambleja e Përgjithshme – Organi më i lartë vendimmarrës
- 2) Administratori – Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre janë të përcaktuar në Statutin e shoqërisë.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhëniet me të tretët nga administratori, i cili ushtron të drejtat në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 8

Administrator i shoqërisë do të jetë Melita Murati, e bija e Rasimit, e datëlindjes 20 Prill 1974, lindur në Fushë-Lurë Dibër dhe banuese në Tiranë me adresë Çollak; Nd. 216; Farkë; Farkë e Vogël; 1045, gjendja civile "e martuar", madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. 035139770 dhe numër personal H45420070V.

Neni 9

Detajet në lidhje me menaxhimin e Kapitalit themeltar, transferimin, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, menaxhimin administrativ të shoqërisë, balancat kontabël dhe financiare, falimentimin si dhe likuidimin etj., janë të përcaktuara qartësisht në Statutin e Shoqërisë.

Neni 10

Ky Akt Themelimi u hartua ne 4 (katër) kopje.

Unë, ortaku i vetëm Melita Murati do të kryej regjistrim e kësaj shoqërie sipas procedurave në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

I&M-1998 shpk

MELITA MURATI

Melita Murati

